



ANALIZË E SHKURTËR POLITIKE, KOSOVË



Konrad
Adenauer
Stiftung

UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS – INTEGRITETI AKADEMIK NË RREZIK

Prill 2014

www.kas.de/kosovo

Dr. Qëndrim R. Gashi

Profesor i asocuar

Universiteti i Prishtinës*

[Përkthyer nga origjinali në anglisht]



1. KONTEKSTI DHE RËNDËSIA E PROBLEMIT

1.1. Hyrje

"Mundësia që Universiteti të arrijë qëllimet e veta varet nga cilësia dhe integriteti i punës akademike që e bëjnë pedagogët, stafi dhe studentët. Liria akademike mund të lulëzojë vetëm në një komunitet të studiuesve të cilët e pranojnë se integriteti intelektual, së bashku me të drejtat dhe përgjegjësitë që e shoqërojnë atë, qëndron në thelb të misionit të tyre. Respektimi i ndershmërisë themelore në punën, fjalët, idetë dhe veprimet e një njeriu është parim me të cilin duhet të pajtohen të gjithë anëtarët e komunitetit."¹

Sipas Qendrës Ndërkombëtare për Integritet Akademik, integriteti akademik është "zotimi, edhe kur përballemi me vështirësi të jashtëzakonshme, ndaj pesë vlerave fundamentale: ndershmërisë, besueshmërisë, paanësisë, respektit dhe përgjegjësisë."² Në vitin 2013, kësaj liste iu shtua edhe vlera e gjashtë, "guximi për të vepruar bazuar mbi ato vlera edhe kur përballemi me vështirësi"³.

Kohëve të fundit akuzat për shkelje të rënda të normave themelore të integritetit të studimit tronditën universitetin më të madh në Kosovë, Universitetin e Prishtinës. Këto akuza prekin jo vetëm reputacionin e universitetit më të vjetër në Kosovë, por edhe cilësinë e rezultateve të të nxënimit dhe përvojat të cilat u ofrohen studentëve të këtij institucioni. Dhe është pikërisht kjo cilësi e rezultateve të të nxënimit e "jo kohëzgjatja e shkollimit, e cila e bën diferencën."⁴ Prandaj, kapitali njerëzor, inovacioni dhe njohuritë janë viktimat e një mjedisi akademik pa integritet, e rrjedhimisht impakti ndjehet edhe nga shoqëria e gjerë.

Ky Policy Brief paraqet një pasqyrë të shkurtër të gjendjes së integritetit akademik në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, me theks në universitetet publike, dhe jep disa rekomandime konkrete për adresimin e gjendjes së tanishme alarmante.

1.2. Debatet e kohëve të fundit për Universitetin e Prishtinës

Tetori 2013 nuk ishte vetëm fillimi i një viti të ri akademik në Universitetin e Prishtinës (UP). Ai po ashtu shënoi fillimin e shturjes së rrjetit të praktikave të korruptuara dhe shkeljeve tejet serioze të integritetit akademik në institucionin kryesor të arsimit të lartë në Kosovë. Gjithçka filloi me lajmin se udhëheqësit e universitetit kishin botuar artikuj me cilësi jashtëzakonisht të dobët në revista shkencore ndërkombëtare të dyshimta në mënyrë që të avancoheshin në grada më të larta akademike.

Reputacioni i universitetit u dëmtua edhe më shumë kur një muaj e gjysmë më pas policia arrestoi 11 individë të cilët vepronin si pjesë e një zinxhiri kriminal i cili po i influenconte vendimet e ndryshme të universitetit, duke filluar nga regjistrimi i studentëve dhe notat e deri në emërimet në administratë.

Dhe *coup de grâce* (goditja përfundimtare) ndodhi kur një artikull humoristik që përqeshte Karl Marks-in dhe menaxhmentin e universitetit u paraqit në të njëjtën revistë në të cilën kishte botuar rektori i atëhershëm i UP-së dhe disa kolegë të tij.

Shpërthimi që pasoi u manifestua në formë të protestave të studentëve para Rektoratit të UP-së, të cilave iu bashkëngjitën edhe aktivistë të shquar të shoqërisë civile dhe të drejtave të njeriut dhe përfaqësues të mediave. Gjatë protestës u përdor dhunë kundër dhe nga protestuesit, edhe pse nuk është e qartë se kush i filloi rastet e dhunës në secilin rast. Protestuesit kërkuan dorëheqjen e rektorit dhe pas një përpjekjeje dyjavore kërkesa e tyre u plotësua. Integriteti akademik, i papërfillur për një kohë të gjatë në këtë pjesë të botës, e fitoi betejën e parë, por sfida të mëdha akoma mbetin për UP-në dhe për të gjitha institucionet e tjera të arsimit të lartë në Kosovë, si publike ashtu edhe private.

¹ Princeton University (2013), *Rights, Rules, and Responsibilities*

² The Center for Academic Integrity (1999), *The Fundamental Values of Academic Integrity*

³ The Center for Academic Integrity (2013), *The Fundamental Values of Academic Integrity*

⁴ OECD (2010), *The High Cost of Low Educational Performance: The Long-run Economic Impact of Improving PISA Outcomes, PISA, OECD Publishing*



1.3. Sfond për Universitetin e Prishtinës dhe për universitetet e tjera publike në Kosovë

I themeluar në vitin 1970, Universiteti i Prishtinës (UP) ka qenë institucion qendror në sistemin e arsimit në Kosovë. Deri para një dekade ai ishte i vetmi universitet në Kosovë.

Që nga fillimi, UP-ja luajti një rol kyç në zhvillimet politike në Kosovë dhe në të njëjtën kohë ishte edhe viktimë e ndërhyrjeve politike.

Ajo ishte skenë e protestave masive të udhëhequra nga studentët në vitin 1981 në të cilat kërkoheshin më shumë të drejta për shqiptarët në ish-Jugosllavi, por po ashtu përjetoi spastrime intelektuale dhe kanosje nga regjimi komunist jugosllav.

Është me rëndësi të theksohet se për shkak të mungesës së stafit akademik, gjatë dekadës së parë të ekzistimit të saj, UP-ja ftoi ligjërues mysafirë nga universitetet e tjera të ish-Jugosllavisë (nga Beogradi, i Zagrebi, etj.) dhe nga Universiteti i Tiranës. Mund të thuhet se, fatkeqësisht, mobiliteti hyrës në vitet 1970-ta ishte shumë më i fuqishëm se në dekadat e mëvonshme dhe se ai mobilitet kishte pasojë të rëndësishme pozitive në ndërtimin e një ambienti intelektual në dhe përreth UP-së.

Gjatë viteve të 1990-ta, UP-së i ishte ndaluar puna nga regjimi i Millosheviqit dhe ajo ishte detyruar të funksiononte në shtëpi private, nën shtypje dhe frikësim dhe i izoluar nga pjesa tjetër e botës. UP-ja ishte shtëpia e 'elitës intelektuale' e cila shpejt u bë 'elitë politike' e shtetit të aspiruar dhe e cila organizoi përpjekjen pacifiste të viteve 1990-ta për pavarësinë e Kosovës. UP-ja në mënyrë të pashmangshme u fut nën kontrollin e asaj elite. Pas luftës, ndikimi mbi universitetin u zëvendësua dhe tani ai ndikim ushtrohej nga partitë politike të dala nga lufta e armatosur 1998-1999. Dhe sërish, universiteti u gjend nën zhvillimet politike, me pasojë serioze për mundësinë e tij që të përmbushte misionin e vet.

Në periudhën pas vitit 1999 në Kosovë institucionet private fitimprurëse të arsimit të lartë mbinë si kërpudhat. Përveç kësaj, numri i studentëve të regjistruar në universitete u rrit jashtëzakonisht shumë. Për shembull, numri i studentëve të UP nga viti 2007 është shtuar më shumë se dyfish, pa rritje përkatëse të stafit ose pa investime në infrastrukturë,

duke pasur kështu një efekt katastrofik në cilësinë e studimeve që ofrohen në UP.

Universiteti i dytë publik i Kosovës (në gjuhën shqipe) u hap në Prizren në vitin 2010. Pas vendimeve, të cilat lehtësisht mund të interpretohen si vendime pa planifikim dhe përgatitje adekuate, më pastaj u hapën edhe katër universitete të tjera publike në vitin 2012, në katër qytete të ndryshme (Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, dhe Pejë). Këto institucione të reja përballen me sfida thelbësore për sigurimin e stafit të kualifikuar akademik dhe stafit administrativ, krahas të pasurit e një udhëheqje e cila shpesh njolloset nga akuzat për favorizime dhe për nepotizëm. Prandaj, rreziku i sakrificimit të integritetit akademik që nga fillimi në këto institucione është shumë i lartë.

Për më tepër, ndërhyrjet politike në vendime të brendshme vazhdojnë të paraqesin një problem serioz në pothuaj të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

1.4. Konteksti rajonal dhe shoqëror

Sektori i arsimit të lartë në Kosovë mbetet më i izoluar se në vendet e tjera të rajonit, por kur është fjala për problemet me integritetin akademik dhe korrupsionin, Kosova është vetëm një pjesë e enigmës më të madhe të Ballkanit.

Një studim i bërë në 2003-2004 në Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Moldavi dhe Serbi konstatonte se "[...] në Evropën Juglindore ka një nivel të lartë të korrupsionit dhe se rezistenca ndaj ambientit korruptiv është minimale. [...] Një përqindje e madhe e studentëve po ashtu dinë për raste të dhënies së mitos për notë ose për provim. [...]"⁵

Në dy dekadat e fundit, në vendet e rajonit ka pasur një ekspansion të shpejtë të numrit të institucioneve të arsimit të lartë e po ashtu një 'masivizim' brenda institucioneve publike. Përveç kësaj, për shkak të problemeve serioze me sundimin e ligjit, universitetet shpesh bien viktimë e ndikimeve të paligjshme politike nga politikanë të fuqishëm ose nga grupe kriminale.

⁵ M. Popovic, *Corruption and academic Malpractice: the Students' View point, The Management of University Integrity, Proceedings of the Seminar of the Magna Charta Observatory, 19 September 2007, Bononia University Press*



Në shumë universitete, nuk ka mbikëqyrje të duhur, të cilën shumë profesorë e interpretojnë si liri akademike nga llogaridhënia, duke e rënduar kështu edhe më shumë situatën. "Në ato vende ku sektori privat është përhapur më së shumti (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni), punësimi i profesorëve në shumë vende po ashtu në mënyrë substanciale e ka degjeneruar procesin arsimor në universitetet publike."⁶

Disa nguten që të fajësojnë "dështimin" e tregut për cilësinë e dobi të shumë prej institucioneve fitimprurëse të arsimit të lartë, por mund të argumentohet se janë qeveritë, të cilat përmes praktikave të dyshimta të punësimit në sektorin publik, si dhe një asimetri informative, që po i mbajnë artificialisht në këmbë shumë prej këtyre institucioneve. Në fakt, korrupsioni dhe nepotizmi, si dhe mungesa e informatave të nevojshme, krijojnë nevojë për diploma të cilat nuk i pajisin të diplomuarit me aftësitë dhe njohuritë adekuate.

Ndikimi i universiteteve në shoqëri është i dyanshëm. Për shembull, studentët të cilët janë të përfshirë në veprime të pandershme kanë më shumë gjasa që të sillen ashtu edhe në vendin e punës.⁷ Në të njëjtën kohë, gjendja është më delikate për universitetet, pasi që "për qëllime shoqërore, dukja është më e rëndësishme sesa përmbajtja. Kështu, integriteti bëhet standard i pranishëm së universitetit në shoqëri."⁸

Shumica e universiteteve në Ballkan kanë edhe shumë për të bërë për të adresuar sjelljen e keqe akademike dhe cilësinë e ulët të studimeve dhe kërkimeve. Ideja e Von Humboldtit e jo vetëm përparimit të kërkimit dhe të të menduarit, por "arsimimi gjithëpërfshirës humanist" duhet të fitojë më shumë beteja.

2. KRITIKË E OPSIONEVE TË POLITIKAVE AKTUALE

Një studim i kohëve të fundit propozoi një model të dobishëm për matjen e integritetit akademik, AIMM

(Academic Integrity Maturity Model).⁹ Në përpjekje për të krahasuar integritetin akademik në BE, aty ofrohen nëntë kategori për përcaktimin e "nivelet të pjekurisë" së integritetit akademik në një vend. Këto kategori janë:

1. Transparenca në integritetin akademik dhe në sigurimin e cilësisë;
2. Politikat e drejta, efektive dhe konsistente për të trajtuar plagjiaturën dhe pandershmërinë akademike;
3. Rangu standard i ndëshkimeve standarde për plagjiaturë dhe pandershmëri akademike;
4. Përdorimi i veglave digjitale dhe regjistrave gjuhësorë;
5. Strategjitë dhe masat parandaluese;
6. Komunikimi rreth politikave dhe procedurave;
7. Njohuritë dhe të kuptuarit e integritetit akademik;
8. Ofrimi i trajnimit për studentë dhe mësime;
9. Kërkimet dhe inovacioni në integritetin akademik.

UP-ja dhe universitetet e tjera publike në Kosovë nuk ishin pjesë e këtij studimi të lartcekur. Megjithatë, sipas të gjitha gjasave ato do të vlerësoheshin jashtëzakonisht dobët në secilën prej këtyre nëntë kategorive.

Për shembull, përkundër vështirësive serioze në muajt e kaluar, Universiteti i Prishtinës ende nuk e ka hapur një debat publik, të hollësisht dhe introspektiv për integritetin akademik. Ushtruesit e detyrës së udhëheqësve të UP-së ende nuk kanë dhënë shenja se e kanë kuptuar sa e rëndë është gjendja e integritetit si të stafit ashtu edhe të studentëve.

⁶ P. Zgaga et al, *Higher Education in the Western Balkans: Reforms, developments, trends*, Faculty of Education, University of Ljubljana, CEPS, Ljubljana, 2013

⁷ S. Nonis and C. O. Swift (2001), *An examination of the relationship between academic dishonesty and workplace dishonesty: A multicampus investigation*, Journal of Education for Business, November/December, 60-76

⁸ Observatory Collegium and ESIB (European Students' Union) Executive Board (2005), *Statement of Concern*, in *Academic Malpractice, Threats and Temptations*, Bononia University Press 2007

⁹ I. Glendinning, *Comparison of Policies for Academic Integrity in Higher Education across the EU*, IPPHEA Consortium, October 2013

Organi që do të duhej të adresonte me urgjencë çështjet e sjelljes së keqe akademike në UP, Komisioni për Etikë, nuk është funksional dhe disa anëtarë të tij edhe vet janë njothosur nga akuzat e fundit. Universitetet e tjera publike as që kanë krijuar mekanizma të tillë.

Stafi i universitetit dhe studentët nuk informohen për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Ata nuk e kanë të qartë se cilat procedura duhet ndjekur nëse kanë ndonjë problem ose ankesë.

Universitetet në Kosovë nuk kanë mbetur prapa vetëm në fushën e politikave. Edhe sa i përket ekzistimit të strukturave të duhura të brendshme të cilat do të adresonin ankesat, universitetet duhet të bëjnë shumë më tepër. Një shembull ilustrues i kësaj është mosekzistimi i Avokatit të Studentëve (Ombudspersonit), i cili do të mund të ofronte studentëve këshilla joformale dhe në besim lidhur me shqetësimet e tyre.

Një shembull i mirë në rajon është Ombudspersoni i Studentëve në Universitetin e Shenjtve Kiril dhe Metodije në Shkup, roli i të cilit sipas kryesueses, znj. Simona Jandrevska, është që të "ndërmjetësojë në kontestet që ngrihen në mes të studentëve dhe administratës së universitetit, personelit akademik siç janë asistentët dhe profesorët, si dhe për të edukuar studentët për të drejtat dhe obligimet që kanë sipas ligjeve që mbrojnë dhe avancojnë arsimin e lartë."¹⁰ Znj. Jandrevska thekson se Ombudspersoni i Studentëve "ka kontribuar në rritjen e vetëdijes se duhet të ketë një kod etik të sjelljes në universitet."¹¹

Po ashtu, në aspektin më të përgjithshëm, universitetet publike nuk ia kanë dalë të zbatojnë një mbikëqyrje të duhur sistemike dhe të krijojnë llogaridhënie financiare, ligjore dhe etike. Përveç kësaj, nuk adresohet as ndërhyrja politike në universitet.

3. REKOMANDIME PËR POLITIKA

Për të adresuar problemet në fushën e integritetit akademik, kjo përmbledhje e politikave u rekomandon institucioneve arsimit të lartë në Kosovë si vijon:

- Komuniteti akademik në Kosovë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

duhet të fillojnë një debat të hapur, të hollësishëm dhe thelbësor për integritetin akademik dhe etikën në universitete, i cili duhet të përfshijë studentët, stafin, shoqërinë civile dhe mediat.

- Universitetet duhet të ftojnë në rezidencë studiues të etikës dhe administratorë që kanë arritur rezultate në luftën për integritet akademik.
- MASHT-i duhet të iniciojë një Ditë të Integritetit Akademik, ku çdo vit do të mbahen manifestime të rëndësishme.
- Universitetet duhet të miratojnë, publikojnë dhe t'ua shpërndajnë të gjithë studentëve, të tanishëm dhe të ardhshëm, Kodin e Sjelljes, i ngjashëm me *Të Drejtat, Rregullat dhe Përgjegjësitë* e Universitetit të Princetoneit (2013). Të gjithë studentëve dhe stafit duhet tu kërkohet të nënshkruajnë një dokument ku konfirmojnë se i kanë lexuar, kuptuar dhe pranuar rregullat dhe përgjegjësitë e Kodit të Sjelljes.
- Kodi për Etikë i Universitetit të Prishtinës duhet të harmonizohet me Kodin e lartcekur të Sjelljes, (për shembull, ai duhet të specifikojë procedurat e ankesave, ndëshkimet, etj.) dhe duhet të aplikohet edhe për menaxhmentin dhe stafin, e jo vetëm për stafin akademik.
- Universitetet duhet të kenë Komisionin për Etikë dhe në rast se ai tashmë ekziston, ai duhet të punojë në mënyrë transparente, i papenguar nga ndonjë ndikim i paligjshëm.
- Universitetet duhet që në mënyrë periodike të publikojnë një listë anonime të të gjitha rasteve të paraqitura për masa disiplinore lidhur me ndonjë sjellje të keqe akademike.
- Universitetet duhet të themelojnë institucionin e Ombudspersonit të Studentëve.
- Universitetet duhet të krijojnë notën XF, e cila jepet në rastet e mashtrimit.
- Universitetet duhet në mënyrë të përbashkët, nën një ombrellë, t'i bashkohen Asociacionit Ndërkombëtar të Universiteteve, një asociacion botëror i institucioneve të arsimit të lartë i vendosur në UNESCO, dhe t'i zbatojnë deklaratimet e politikave të tyre.

¹⁰ *Komunikim privat*

¹¹ *Ibid.*



- Universitetet duhet që bashkërisht të shkëmbejnë përvojat me Qendrën Ndërkombëtare për Integritet Akademik.
- Universitetet duhet të inkurajojnë mobilitetin dhe shkëmbimet rajonale.
- Universitetet duhet të krijojnë një arkiv [regjistër] elektronik të përbashkët të të gjitha doktoraturave dhe një listë të punimeve të publikuara shkencore nga stafi i tyre akademik.

Rekomandimet më lartë mund të kenë sukses vetëm në një ambient më të gjerë ku sundon ligji dhe ku ekzistojnë mekanizmat e duhur dhe funksionalë të mbikëqyrjes, dhe ku ka menaxhment të aftë, me vullnet, transparent dhe llogaridhënës në universitete. Megjithatë, serioziteti i situatës kërkon veprime të menjëhershme dhe konsistente.

Në përfundim, një paragraf nga raporti i famshëm Kalven në Universitetin e Çikagos na përkujton rolin e universiteteve: "Misioni i një universiteti është zbulimi, përmirësimi dhe shpërndarja e njohurive. Fusha e tij e kërkimeve dhe analizës së hollësishme përfshin të gjitha aspektet dhe të gjitha vlerat e shoqërisë. Një universitet që i qëndron besnik misionit të tij do të paraqes sfida afatgjate për vlerat sociale, politikat, praktikat dhe institucionet. Sipas dizajnit dhe efektit, ai është një institucion i cili krijon pakënaqësi me aranzhimet ekzistuese sociale dhe propozon aranzhime të reja. Shkurt, një universitet i mirë, si Sokrati, do të jetë tronditës."¹²

Universitetet e Kosovës duhet të shkaktojnë tronditje përmes ideve të tyre dhe zbulimeve të diturisë, dhe jo përmes skandaleve akademike. Përndryshe, alternativa e kësaj e vë në rrezik tërë sistemin arsimor të Kosovës dhe ua vjedh qytetarëve dhe vendit të ardhmen prosperuese.

¹² *University of Chicago (1967), Kalven Report, University of Chicago Record, Vol. 1, No. 1, 11 November 11, 1967*



Burimet e konsultuara ose të rekomanduara

- [1] The Center for Academic Integrity (1999), *The Fundamental Values of Academic Integrity*
- [2] The Center for Academic Integrity (2013), *The Fundamental Values of Academic Integrity*
- [3] I. Glendinning, *Comparison of Policies for Academic Integrity in Higher Education across the EU*, IPPHEAE Consortium, October 2013
- [4] S. Nonis and C. O. Swift (2001), *An examination of the relationship between academic dishonesty and workplace dishonesty: A multicampus investigation*, Journal of Education for Business, November/December, 60-76
- [5] Observatory Collegium and ESIB (European Students' Union) Executive Board (2005), *Statement of Concern*, in *Academic Malpractice, Threats and Temptations*, Bononia University Press 2007
- [6] OECD (2010), *The High Cost of Low Educational Performance: The Long-run Economic Impact of Improving PISA Outcomes*, PISA, OECD Publishing
- [7] M. Popovic, *Corruption and academic Malpractice: the Students' View point, The Management of University Integrity*, Proceedings of the Seminar of the Magna Charta Observatory, 19 September 2007, Bononia University Press
- [8] Princeton University (2013), *Rights, Rules, and Responsibilities*
- [9] University of Chicago (1967), *Kalven Report*, University of Chicago Record, Vol. 1, No. 1, November 11, 1967
- [10] P. Zgaga et al, *Higher Education in the Western Balkans: Reforms, developments, trends*, Faculty of Education, University of Ljubljana, CEPS, Ljubljana, 2013.

Rreth Autorit:

Dr. Qëndrim R. Gashi është profesor i asocuar i matematikës në Universitetin e Prishtinës. Më parë ai ishte EPDI Fellow 2008-2010 në Bon, Kembrixh dhe Paris. Ai ka studiuar në Universitetin e Çikagos (PhD 2008, MS 2004), në Universitetin e Kembrixhit (MA St 2003) dhe në Universitetin e Prishtinës (Diplomë 2002).

[* Pikëpamjet e autorit dhe jo doemos ato të institucionit ku ai punon.]

Pikëpamjet e shprehura në këtë shkrim janë pikëpamje personale të autorit dhe nuk paraqesin doemos pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung.

Kontakt:

Konrad-Adenauer-Stiftung
Zyra në Kosovë
Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6
KO-10000 Prishtinë
Telefon +381 (0) 38 229 874
Prishtina@kas.de
www.kas.de/kosovo